



STOP KRIZËS
NDRYSHO KOSOVËN
PDK 125

PROGRAMI ZGJEDHOR
2026

HYRJE

- I.** Çmime e tatime më të ulëta, paga e pensione më të larta dhe mbështetje për bizneset
- II.** Investime në energji, infrastrukturë dhe teknologji të reja
- III.** Shëndetësi cilësor, me shërbime më të shpejta dhe të qasshme për të gjithë
- IV.** Arsimit konkurrues, aftësi për të ardhmen dhe mundësi për të rinjtë
- V.** Drejtësi e pavarur, e paanshme dhe efikase
- VI.** Kultura, rinia dhe sporti
- VII.** Siguria
- VIII.** Politika e jashtme
- IX.** Sovraniteti Digjital dhe Inteligjenca Artificiale

FJALË HYRËSE

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Sot, Kosova po jeton në krizë. Familjet kosovare janë të lodhura. Të lodhura nga çmimet që rriten vazhdimisht, ndërsa pagat mbesin të pamjaftueshme. Të lodhura nga një sistem shëndetësor që nuk funksionon siç duhet. Të lodhura nga një sistem arsimor që nuk u ofron fëmijëve dhe të rinjve mundësitë që meritojnë.

Ndërsa jeta po bëhet çdo ditë e më e vështirë, shumë të rinj nuk e shohin më të ardhmen e tyre në Kosovë. Pensionistët tanë mezi arrijnë t'i blejnë ilaçet e nevojshme dhe shpesh detyrohen të zgjedhin cilat prej tyre mund t'i përballojnë. Bizneset vazhdojnë të përballen me pengesa, sepse në vend që t'i mbështesë, qeveria ua vështirëson punën dhe zhvillimin.

Sot, duhet t'ia bëjmë vetes vetëm një pyetje: si ta ndalim krizën?

Sepse Kosova meriton më shumë. Ju meritoni një qeveri që ju sjell më shumë siguri, më shumë mundësi dhe një jetë më të mirë.

Të dashur qytetarë,

Çdo votë për Partinë Demokratike të Kosovës është një votë për ta nxjerrë Kosovën nga kriza. Plani ynë është konkret, i realizueshëm dhe i përqendruar te përmirësimi i jetës së çdo qytetari. Prandaj edhe slogani ynë është i qartë:

Stop Krizës. Ndrysho Kosovën.

Me qeverinë e udhëhequr nga ne, shteti do të kthehet kah qytetari. Puna, dijenia dhe ndershmëria do të shpërblehen. Do ta rikthejmë besimin në institucione dhe shpresën për të ardhmen. Do të ndërtojmë një Kosovë ku secili qytetar ndihet i vlerësuar, ku secila familje ka mundësi për një jetë më të mirë dhe ku të rinjtë zgjedhin të ndërtojnë të ardhmen e tyre këtu, në vendin e tyre.

Është koha t'i themi stop krizës.

Është koha ta ndryshojmë Kosovën.

Unë besoj në një Kosovë ku paga nuk merret vetëm për ta kaluar muajin, por për të jetuar me dinjitet. Në një Kosovë ku pensionistët nuk harrohen, por respektohen. Në një Kosovë ku biznesi vendor mbështetet, ku prodhuesit tanë fuqizohen dhe ku të rinjtë nuk detyrohen të largohen nga vendi i tyre.

STOP KRIZËS
NDRYSHO KOSOVËN
PDK 125

Ne do ta ulim barrën tatimore për qytetarët dhe bizneset. Do t'i rrisim pagat dhe pensionet. Do të krijojmë vende të reja pune. Do të investojmë në energji, infrastrukturë, shkolla dhe spitale moderne. Sepse zhvillimi ekonomik nuk është një premtim bosh apo një statistikë e ftohtë. Zhvillimi është buka në tavolinë, është ngrohja në dimër, është shpresa për të nesërmen.

Programi ynë, të cilin po e shpalojmë para qytetarëve, është real dhe mbështetet në përvojën tonë të dëshmuar në ndërtimin e Kosovës, si dhe në historinë tonë të lirisë dhe pavarësisë.

Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm. Ju duhet të kërkonti që ky potencial të shndërrohet në zhvillim dhe mirëqenie. Ne kemi rininë më energjike në rajon. Kemi diasporën që nuk e ka harruar vendin e vet. Kemi njerëz punëtorë, kreativë dhe të mençur. Ajo që na mungon është drejtimi i duhur dhe guximi për të marrë vendime të mëdha.

Ajo që nuk na nevojitet është gjuha e urrejtjes, polarizimit dhe ndasive mes nesh; debatet për atë se cilës parti i përket dikush apo në cilin qytet ka lindur.

Do ta ndërtojmë një shtet që funksionon. Një shtet ku drejtësia nuk ndikohet nga politika dhe ku Kushtetuta nuk shkelet sa herë që i konvenon pushtetit.

Do ta ndryshojmë Kosovën me punë, jo me fjalë. Me rezultate, jo me arsyetime. Me zhvillim të vazhdueshëm, jo me krizë të përhershme.

Ne nuk premtojmë mrekulli brenda natës. Por premtojmë diçka shumë më të rëndësishme: menaxhim të përgjegjshëm, plane reale, përkushtim të plotë, punë të ndershme dhe vendime që e vendosin qytetarin në qendër të çdo politike.

Unë besoj në Kosovën që del nga kriza dhe ngrihet në lartësinë e potencialit të saj.

Besoj në Kosovën që prodhon.

Besoj në Kosovën që fiton.

Besoj në Kosovën ku ëndrrat e fëmijëve tanë realizohen këtu, në vendin e tyre.

Lexojeni programin tonë. Na ndiqni dhe komentoni në rrjetet sociale ndërsa e prezantojmë gjatë ditëve në vijim. Na dërgoni propozimet tuaja dhe na kritikoni kur nuk pajtoheni me ne. Jemi të hapur për debat, sepse nuk besojmë në përjashtim dhe polarizim.


Por mbi të gjitha, le të punojmë së bashku për t'i thënë stop krizës. Le t'i hapim rrugë shpresës. Le ta ndryshojmë Kosovën.

Stop Krizës. Ndrysho Kosovën.

Bedri Hamza



***I. Çmime e tatime më të
ulëta, paga e pensione më të larta dhe
mbështetje për bizneset***

The background features a dark blue color scheme with several financial-themed elements. On the right side, there are three vertical stacks of coins. Overlaid on this are several upward-pointing blue arrows of varying sizes. In the lower half, there are line graphs with circular markers and a percentage sign (%). The overall aesthetic is professional and business-oriented.

1. Çmime e tatime më të ulëta, paga dhe pensione më të larta, mbështetje për bizneset

Në vitet e fundit, rritja e çmimeve dhe kostos së jetesës nuk është shoqëruar me rritje të mjaftueshme të të ardhurave. Kjo ka krijuar presion të madh mbi familjet kosovare, ka ulur fuqinë blerëse dhe ka rritur pasigurinë sociale. Për këtë arsye, Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do të ndërmarrë masa të qarta, të matshme dhe të qëndrueshme për të përmirësuar mirëqenien ekonomike dhe sociale të çdo qytetari e çdo familjeje.

Mirëqenia sociale është treguesi më i drejtpërdrejtë

i suksesit të një qeverie. Një shtet që synon stabilitet dhe zhvillim të qëndrueshëm duhet të sigurojë që rritja ekonomike të reflektohet realisht në jetën e qytetarëve — veçanërisht për ata që varen nga paga apo pensioni.

1.1 Paga që vlerësojnë punën

Qeveria e PDK-së angazhohet për rritje prej 50% të pagave në sektorin publik, si masë e domosdoshme për të ruajtur dinjitetin e punës publike dhe për të përmirësuar standardin e jetesës së punonjësve. Kjo rritje do të zbatohet në mënyrë të planifikuar dhe të qëndrueshme, duke përfshirë mësimdhënësit, stafin shëndetësor, administratën publike, shërbimet e sigurisë dhe sektorët e tjerë publikë.

Rritja e pagave synon jo vetëm përmirësimin e mirëqenies së punonjësve, por edhe rritjen e motivimit, profesionalizmit dhe cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët. Një sektor publik i vlerësuar dhe i paguar dinjitetshëm është parakusht për një shtet funksional dhe të besueshëm.

Kjo është investim në institucionet, jo shpenzim.

Pensione dhe ndihma sociale që mbrojnë familjet kosovare

PDK angazhohet për rritje prej 50% të pensioneve dhe ndihmave sociale, me qëllim që asnjë pension apo përfitim social të mos jetë më i ulët se 250 euro në muaj. Kjo masë synon mbrojtjen e pensionistëve dhe përfituesve të ndihmës sociale nga varfëria dhe pasiguria ekonomike, duke siguruar një minimum jetik dinjitoz që kontribuon në stabilitetin social dhe solidaritetin shoqëror.

Sistemi social do të bazohet në parimet e drejtësisë, transparencës dhe qëndrueshmërisë buxhetore. Mirëqenia sociale nuk është kosto — është investim në stabilitet, kohezion shoqëror dhe zhvillim afatgjatë.

PDK-ja nderon sakrificat e mëdha të luftëtarëve të lirisë dhe familjeve të tyre. Për këtë arsye:

- Përfitimet e të gjitha kategorive të luftës, duke përfshirë familjet e dëshmorëve, veteranët dhe invalidët e luftës, do të rriten për 50%
- Prindërit e familjeve të dëshmorëve nuk do të detyrohen të zgjedhin ndërmjet pensionit të moshës dhe pensionit të familjes së dëshmorit — do t'i përfitojnë të dyja llojet e pensioneve
- Do të hiqen kufizimet për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfitues të pensionit të veteranit, që të jenë aktivë në tregun e punës


1.3 Tatime më të përshtatshme në pagë

Të ardhurat mujore deri në **500 euro** do të jenë **tërësisht të lira nga tatimi për të gjithë**, me qëllim mbrojtjen e shtresave me të ardhura të ulëta dhe përballimin e kostos së jetesës.

Të ardhurat mujore nga **500 deri në 800 euro** do të taten me normën 8%, ndërsa të ardhurat mbi 800 euro me normën **10%**, duke vendosur një sistem progresiv që rrit drejtësinë sociale dhe mbron shtresën e mesme.

Ligji aktual për **tatimin në pronë do të shfuqizohet**, pasi ka krijuar barrë të panevojshme financiare për familjet dhe bizneset.

Politika tatimore do të riformulohet në mënyrë që të jetë e drejtë, e përbalueshme dhe e qëndrueshme.



1.4 Mbështetje për familjet dhe fëmijët

Qeveria e PDK-së do të zbatojë **shtesë mujore për çdo fëmijë deri në moshën 16 vjeçare**, si politikë universale për mbështetjen e familjeve. Kjo shtesë synon të ndihmojë familjet në përballimin e shpenzimeve të përditshme për ushqim, arsim, shëndetësi dhe aktivitete zhvillimore. Njëkohësisht, kjo politikë përfaqëson investim afatgjatë në zhvillimin njerëzor dhe në të ardhmen e Kosovës.

Mbështetja për fëmijët është mbështetje për shoqërinë në tërësi. PDK do të zbatojë gjithashtu politika të posaçme për **përkrahjen e lehonave**, duke mbrojtur nënat e reja, familjet e tyre dhe njëkohësisht punëdhënësit. Këto politika do të përfshijnë mbështetje financiare për lehonat, mekanizma që garantojnë ruajtjen e vendit të punës dhe ndarje të drejtë të përgjegjësive ndërmjet shtetit dhe sektorit privat. Mbështetja për lehonat do të realizohet përmes **skemave të përbashkëta shtet-punëdhënës**, me përkrahje buxhetore direkte, në mënyrë që lehonat të mos përbëjnë barrë për asnjërën palë.

1.5 0% TVSH mbi produktet esenciale për t'i ulur çmimet

Qeveria e udhëhequr nga PDK do të aplikojë normë **0% të TVSH-së për produkte esenciale të shportës bazë**, me qëllim uljen e menjëhershme të çmimeve dhe mbrojtjen e fuqisë blerëse të qytetarëve.

1.6 Mbështetje direkte për bizneset

Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm kërkon një sektor privat të fuqishëm dhe konkurrues. Qeveria e PDK-së do të krijojë kushte reale për rritjen e bizneseve kosovare, duke adresuar pengesat strukturore që kanë ngadalësuar investimet dhe krijimin e vendeve të punës.

Për bizneset, një nga pengesat kryesore është pagesa e TVSH-së në kufi për mallrat e importuara. Qeveria e PDK-së do ta ndryshojë këtë praktikë, duke e **transferuar pagesën e TVSH-së në brendësi të Kosovës** dhe pas shitjes së produkteve, jo si deri më tani në momentin e importit. Kjo masë:

- përmirëson likuiditetin e bizneseve,
- ul presionin financiar,
- rrit qarkullimin ekonomik,
- krijon kushte më të favorshme për investime dhe punësim.

Bizneset e vogla dhe të mesme janë shtylla kryesore e ekonomisë së Kosovës dhe gjeneruesit kryesorë të vendeve të punës.

Bizneset me qarkullim vjetor deri në **10,000 euro** do të lirohen nga tatimi, për të nxitur formalizimin, sipërmarrjen dhe rritjen e aktivitetit ekonomik. Ndërsa, ato me qarkullim **deri në 30 mijë do të paguajnë tatim vetëm mbi fitimin real.**

Për investimet mbi **500,000 euro** ose investimet që krijojnë mbi **50 vende të reja pune**, do të ofrohen lehtësira të përkohshme tatimore, si instrument për tërheqjen e investimeve strategjike dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Qasja e kufizuar në financa mbetet një nga pengesat kryesore për zhvillimin e bizneseve vendore. PDK angazhohet për:

- zgjerimin e Fondit të Garantimit të Kredive, për të ulur rrezikun dhe normat e interesit.

- subvencione dhe grante që mbulojnë deri në 30% të shumës së investimit, veçanërisht për sektorët prodhues dhe inovativë. Këto grante dhe instrumente mbështetëse do të administrohen përmes thirrjeve publike transparente, me kritere të qarta për përfitim, monitorim të rregullt dhe vlerësim të ndikimit ekonomik.

- krijimin e instrumenteve të reja financiare për bizneset e reja dhe startup-et. Legalizimi i ndërtimeve do të realizohet me tarifa simbolike, duke e futur kapitalin e bllokuar në qarkullim ekonomik. Kjo masë aktivizon miliarda euro pasuri të paluajtshme, zgjeron bazën tatimore dhe krijon mundësi të reja investimi e zhvillimi. Kapitali i çliruar do të gjenerojë




Legalizimi i ndërtimeve do të realizohet me **tarifa simbolike**, duke e futur kapitalin e bllokuar në qarkullim ekonomik. Kjo masë aktivizon miliarda euro pasuri të paluajtshme, zgjeron bazën tatimore dhe krijon mundësi të reja investimi e zhvillimi. Kapitali i çliruar do të gjenerojë aktivitet ekonomik, do të krijojë vende pune dhe do të kontribuojë në rritjen e të ardhurave publike.

Ndërkohë, ndërmarrjet publike do të reformohen thellësisht. Qëllimi është që ato të mos jenë barrë për buxhetin e shtetit, por faktorë aktivë të zhvillimit ekonomik dhe punësimit. Qeveria e PDK-së do të krijojë bazën ligjore dhe institucionale për **përfshirjen graduale të ndërmarrjeve publike në tregun e letrave me vlerë**, përmes listimit të pjesshëm në Bursën e Kosovës. Kjo masë synon rritjen e transparencës, përmirësimin e qeverisjes korporative, mobilizimin e kapitalit dhe forcimin e llogaridhënies — pa cenuar pronësinë publike dhe pa rrezikuar asetet strategjike të shtetit.

Për papunësinë, Qeveria e PDK-së do të krijojë **Fondin për Papunësinë**, si mekanizëm i qëndrueshëm mbrojtës për qytetarët që mbeten pa punë. Fondi do të ofrojë mbështetje financiare të përkohshme, duke u lidhur njëkohësisht me programe trajnimi, rikualifikimi dhe riintegrimi në tregun e punës. Ky mekanizëm synon të reduktojë pasigurinë sociale dhe të ndihmojë qytetarët të kthehen më shpejt në punësim aktiv.





***II. Investime në energji,
infrastrukturë dhe teknologji të reja***

2. Investime në energji, infrastrukturë moderne dhe teknologji të reja

Energjia është baza mbi të cilën ndërtohet çdo ekonomi moderne. Pa furnizim të sigurt, të përballueshëm dhe të qëndrueshëm me energji, as bizneset nuk mund të planifikojnë, as familjet nuk mund të jetojnë me dinjitet, as shteti nuk mund të zhvillohet. Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës e trajton energjinë si çështje të prioritetit kombëtar dhe si parakusht themelor për zhvillim ekonomik e social.

Kosova ka burime energjetike. Çfarë ka munguar është vullneti politik dhe strategjia për t'i shfrytëzuar ato me mençuri, drejtësi dhe vizion afatgjatë. PDK ofron pikërisht këtë.

Qeveria e PDK-së angazhohet për heqjen e TVSH-së (0%) për energjinë elektrike, si masë e drejtpërdrejtë për uljen e faturave mujore dhe për mbrojtjen e standardit jetësor të familjeve. Energjia elektrike është nevojë bazike dhe jo luks. Heqja e TVSH-së:

- ul menjëherë barrën financiare për qytetarët;
- rrit fuqinë blerëse mujore;
- kontribuon në stabilitet social.

2.1 Modernizimi i kapaciteteve ekzistuese

Termocentrali "Kosova B" do të **revitalizohet dhe modernizohet** për të zgjatur jetëgjatësinë e tij për së paku 25 vjet. Modernizimi do të rrisë sigurinë teknike, do të përmirësojë efikasitetin prodhues, do të ulë ndotjen përmes teknologjive më të avancuara dhe do të sigurojë prodhim stabil vendor. Ky investim është jo vetëm energjetik — është garancion i pavarësisë dhe stabilitetit të furnizimit për qytetarët dhe ekonominë.

2.2 Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese - Termocentrali "Kosova e Re" (rreth 500 MW) Siguria energjetike afatgjatë e Kosovës kërkon kapacitete të reja prodhuese vendore. PDK angazhohet për ndërtimin e Termocentralit

"Kosova e Re" me kapacitet rreth 500 MW.

Ky projekt strategjik do të:

- sigurojë furnizim stabil për dekadat e ardhshme;
- zvogëlojë ndjeshëm varësinë nga importi;
- stabilizojë çmimin e energjisë;
- krijojë vende të reja pune dhe zhvillim ekonomik.

2.3 Ngrohje qendrore për qytetarët

Qeveria e PDK-së do të zhvillojë **sisteme të ngrohjes qendrore nga termocentralet ekzistuese** në së paku pesë qytete të Kosovës. Ky projekt do të shfrytëzojë energjinë termike të tepërt që aktualisht humbet, duke e kthyer atë në ngrohje të përballueshme për familjet. Efekti do të jetë i trefishtë: ulje e faturave të ngrohjes për familjet, ulje e ndotjes së ajrit urban dhe rritje e efikasitetit të përgjithshëm të sistemit energjetik. Projektet do të realizohen në bashkëpunim të ngushtë me komunat përfituese.

2.4 Energjia diellore dhe e ripërtëritshme

Qeveria e PDK-së do të realizojë **ndërtimin e një parku solar** në zonën e hirit të termocentraleve, duke e kthyer një hapësirë të degraduar mjedisore në burim të energjisë së pastër. Ky projekt përfaqëson tranzicion energjetik të mençur — njëkohësisht rehabilitim mjedisor dhe investim strategjik.

Qytetarët dhe bizneset do të inkurajohen aktivisht të marrin pjesë në prodhimin e energjisë përmes **subvencioneve 30–50% për panelet solare**. Kjo masë do të kontribuojë në përvetësim më të shpejtë të kësaj teknologjie, rritje të pavarësisë energjetike dhe ulje të faturave. Programet e izolimit termik të banesave, përmirësimi i efikasitetit në ndërtesa publike dhe zëvendësimi i pajisjeve joefikase do të plotësojnë këtë kuadër.

2.5 Diversifikimi i burimeve dhe tranzicioni energjetik

Qeveria e PDK-së angazhohet për **ndërtimin e infrastrukturës së gazit në Kosovë**, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe në përputhje me strategjitë rajonale dhe evropiane. Gazifikimi do të ofrojë një alternativë më fleksibël dhe më të pastër për industri dhe ngrohje, do të ulë varësinë nga një burim i vetëm energjie, do të përmirësojë cilësinë e ajrit dhe do të rrisë sigurinë energjetike afatmesme dhe afatgjatë.

Zbatimi do të jetë gradual dhe i bazuar në analiza të fizibilitetit dhe interesit publik, duke nisur me **projekte pilot në zonat urbane dhe industriale** dhe duke u zgjeruar gradualisht në nivel kombëtar. Zhvillimi i këtyre burimeve nuk do të rrezikojë sigurinë e furnizimit dhe nuk do të krijojë kosto të papërbalueshme për qytetarët.



2.6 Infrastruktura energjetike dhe interkoneksionet

PDK angazhohet për forcimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, zhvillimin e interkoneksioneve rajonale dhe — veçanërisht — realizimin e lidhjes energjetike Kosovë–Shqipëri. Kjo lidhje do të forcojë pozicionin e Kosovës si aktor rajonal energjetik, do të rrisë sigurinë e furnizimit dhe do të hapë mundësi të reja për tregtinë e energjisë.

2.7 Qeverisja e sektorit të energjisë

Sektori energjetik do të qeveriset me rregulla të qarta, transparente dhe të parashikueshme, duke mbrojtur interesin publik dhe konsumatorët. Politikat energjetike të Qeverisë së PDK-së synojnë ta bëjnë energjinë të sigurt, të përbalueshme dhe të qëndrueshme — jo vetëm për sot, por për brezat që vijnë. Energjia e sigurt është baza e zhvillimit ekonomik, punësimit dhe stabilitetit social.

2.8 Infrastruktura si motor i zhvillimit ekonomik

Zhvillimi ekonomik kërkon infrastrukturë moderne dhe funksionale.

PDK angazhohet për:

- përfundimin e projekteve madhore rrugore,
- zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore,
- veçanërisht **lidhjen hekurudhore Kosovë–Shqipëri**, si projekt strategjik ekonomik dhe kombëtar.



III. Shëndetësi cilësore, me shërbime më të shpejta dhe të qasshme për të gjithë

3. Shëndetësi cilësore, me shërbime më të shpejta dhe të qasshme për të gjithë

Shëndetësia nuk është kosto — është investim në mirëqenie, produktivitet dhe stabilitet shoqëror. Një sistem shëndetësor i fortë është themeli i një shoqërie të shëndetshme dhe ekonomie funksionale. Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës angazhohet për ndërtimin e një sistemi shëndetësor modern, të qasshëm, të drejtë dhe cilësor — që i shërben çdo qytetari, pavarësisht vendbanimit, moshës apo gjendjes ekonomike.

Sfidat me të cilat përballet sistemi aktual shëndetësor janë reale: kohë pritjeje të gjata, infrastrukturë e pamjaftueshme, boshllëqe në mbulim territorial dhe mungesë e specializimeve kyçe. PDK ofron zgjidhje konkrete dhe të zbatueshme.

3.1 Zbatimi i plotë i sigurimeve shëndetësore - Mbrojtje financiare për qytetarët dhe familjet

Zbatimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore është prioritet strategjik. Ky sistem do të krijojë bazë të qëndrueshme financiare për shëndetësinë publike dhe do t'i mbrojë qytetarët nga shpenzimet e papërbalueshme shëndetësore.

Sigurimet shëndetësore do të:

- mbulojnë shërbimet bazë dhe specialistike;
- reduktojnë pagesat direkte nga xhepi i qytetarëve;
- rrisin transparencën dhe efikasitetin e financimit;
- lidhin financimin me cilësinë e shërbimit.

3.2 Lista esenciale e barnave dhe furnizimi i rregullt - Barna të sigurta dhe të qasshme

Qeveria e PDK-së do të garantojë furnizim të rregullt dhe të qëndrueshëm me barna esenciale në të gjitha institucionet publike shëndetësore.

Lista e barnave esenciale do të:

- rishikohet dhe zgjerohet;
- përditësohet sipas standardeve bashkëkohore;
- menaxhohet me transparencë të plotë në prokurim.

Asnjë pacient nuk duhet të detyrohet të blejë barna esenciale vetë për shkak të mungesës në sistemin publik.

Qeveria e PDK-së do të sigurojë **barna falas për pacientët me sëmundje kronike**, përmes listës esenciale të barnave dhe sistemit publik shëndetësor. Kjo masë synon të ulë shpenzimet direkte të familjeve, të përmirësojë vazhdimësinë e trajtimit mjekësor dhe të garantojë kujdes dinjitoz për pacientët kronikë.



3.3 Modernizimi i infrastrukturës shëndetësore - Spitale funksionale dhe shërbime moderne

Qeveria e PDK-së do të investojë në modernizimin e spitaleve ekzistuese dhe ndërtimin e infrastrukturës së re shëndetësore.

Kjo përfshin:

- përmirësimin e kushteve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës;
- modernizimin e spitaleve rajonale;
- ndërtimin e **Spitalit Rajonal të Prishtinës**.

Qëllimi është që shërbimet shëndetësore cilësore të ofrohen brenda vendit, pa pasur nevojë për trajtim jashtë Kosovës.

3.4 Themelimi i Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM)

Qeveria e PDK-së do të themelojë **Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore**, me sistem unik kombëtar të dispeçerimit dhe koordinimit të shërbimeve emergjente. QKUM do të përmirësojë reagimin në kohë reale, koordinimin ndërinstytucional dhe shpëtimin e jetës së qytetarëve në raste emergjente.

QKUM do të funksionojë **në bashkëpunim me shërbimet ekzistuese emergjente**, me sistem unik të koordinimit dhe reagimit të shpejtë.

3.5 Pajisje mjekësore dhe teknologji bashkëkohore - Diagnostikim i saktë dhe trajtim në kohë

PDK do të investojë në pajisje moderne diagnostikuese dhe terapeutike, përfshirë:

- aparatura për diagnostikim të avancuar;
- pajisje laboratorike moderne;
- teknologji për trajtim specialistik.

Këto investime do të reduktojnë listat e pritjes dhe do të përmirësojnë cilësinë e trajtimit.


3.6 Kujdesi parësor dhe qasja e drejtpërdrejtë

Reforma e kujdesit parësor shëndetësor është prioriteti i parë. Mjeku i familjes duhet të jetë porta e parë dhe e besueshme e sistemit shëndetësor — i qasshëm, i trajnuar dhe i pajisur mirë. Qeveria e PDK-së do të rrisë kapacitetet e kujdesit parësor në të gjithë vendin, duke

reduktuar ndjeshëm kohën e pritjes dhe duke siguruar shërbime cilësore sa më afër qytetarëve.

3.7 Mjekësia mobile — shërbimi shkon te qytetari

Qeveria e PDK-së do të zhvillojë **shërbimin e mjekësisë mobile**, duke sjellë shërbime shëndetësore bazike dhe specialistike drejtpërdrejt te qytetarët në zonat rurale dhe të largëta. Ky shërbim synon rritjen e qasjes në kujdes shëndetësor dhe barazinë territoriale në shëndetësi — sepse vendbanimi nuk duhet të jetë pengesë për shërbim cilësor.



3.8 Programi Kombëtar për Kancerin

Qeveria e PDK-së do të zbatojë **Programin Kombëtar për Parandalimin dhe Trajtimin e Kancerit**, duke përfshirë skringing të organizuar, diagnostikim të hershëm dhe trajtim sipas standardeve evropiane. Programi synon uljen e vdekshmërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve. Do të mbështetet nga **linja të dedikuara buxhetore**, për të garantuar zbatim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

3.9 Rehabilitimi dhe kujdesi i specializuar

Qeveria e PDK-së do të zhvillojë **qendra rajonale të rehabilitimit neurologjik, kardiak dhe fizik** në të gjithë vendin, për të siguruar trajtim afatgjatë dhe cilësor për pacientët pas sëmundjeve dhe ndërhyrjeve të rënda shëndetësore. Paralel me këtë, PDK do të zhvillojë shërbime të **kujdesit paliativ dhe rehabilitimit**, për të garantuar mbështetje dhe dinjitet për pacientët me sëmundje të rënda dhe familjet e tyre — në çdo fazë të jetës.

3.10 Themelimi i Qendrës Kombëtare për Trajtimin e Varësive

Qeveria e PDK-së do të themelojë **Qendrën Kombëtare për Trajtimin e Varësisë**, për trajtimin e varësisë nga substancat, alkooli dhe format e tjera të varësisë. Kjo qendër do të ofrojë trajtim multidisiplinar, rehabilitim dhe mbështetje sociale për pacientët dhe familjet e tyre — duke adresuar një sfidë shëndetësore dhe sociale që ka mbetur shumë kohë pa përgjigje institucionale adekuate.

3.11 Prodhimi vendor farmaceutik

Qeveria e PDK-së do të mbështesë zhvillimin e **prodhimit vendor farmaceutik**, për të ulur varësinë nga importi, siguruar furnizim të qëndrueshëm me barna dhe krijuar vende të reja pune. Siguria farmaceutike është pjesë e sigurisë kombëtare — dhe PDK e trajton si të tillë.


3.12 Digjitalizimi i shëndetësisë

Sistemi shëndetësor do të digjitalizohet për të rritur efikasitetin, reduktuar burokracinë dhe përmirësuar qasjen e qytetarëve në shërbime. Dosjet elektronike mjekësore, rezervimet online dhe sistemet e referimit digjital do të bëjnë procesin e kujdesit shëndetësor më të shpejtë, më të sigurt dhe më të orientuar nga pacienti.

Shëndetësia e fortë nuk është privilegj — është e drejtë e çdo qytetari. Investimi në shëndet është investimi me kthimin më të lartë shoqëror që një qeveri mund të bëjë.



***IV. Arsim konkurrues, aftësi
për të ardhmen dhe mundësi
për të rinjtë***



4. Arsim konkurrues, aftësi për të ardhmen dhe mundësi për të rinjtë

Arsimi është investimi më strategjik kombëtar. Një sistem arsimor i fortë ndërton qytetarë të aftë, ekonomi konkurruese dhe shtet të qëndrueshëm. Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës angazhohet për ndërtimin e një sistemi arsimor që nxit mendimin kritik, krijon aftësi reale për tregun e punës dhe u jep të rinjve arsye — dhe mundësi — për të ndërtuar të ardhmen e tyre këtu, në Kosovë.

Sistemi arsimor në Kosovë përballet me sfida serioze: cilësi të pabarabartë, infrastrukturë të pamjaftueshme, mospërputhje me tregun e punës dhe mungesë të mbështetjes për mësimdhënësit dhe nxënësit. Këto sfida kërkojnë reformë të thellë dhe vizion afatgjatë.

Rinia është potenciali më i madh i Kosovës. Politikat rinore të Qeverisë së PDK-së do të fokusohen në krijimin e mundësive reale për zhvillim personal, profesional dhe shoqëror. Qëllimi është që të rinjtë të shohin të ardhmen e tyre në Kosovë, jo vetëm jashtë saj.

4.1 Digjitalizimi i arsimit

Arsimi do të digjitalizohet për të rritur cilësinë dhe qasjen në dije. Kjo përfshin pajisjen e nxënësve dhe mësimdhënësve me teknologji moderne, platforma digjitale mësimore dhe zhvillimin e aftësive digjitale që nga mosha e hershme. Teknologjia nuk zëvendëson mësuesin — por e fuqizon atë dhe e bën mësimdhënien më efikase, më interaktive dhe më të lidhur me botën reale.

4.2 Arsimi profesional i lidhur me tregun e punës

PDK angazhohet për forcimin e arsimit profesional, duke e lidhur drejtpërdrejt me nevojat e tregut të punës. Shkollat profesionale do të modernizohen, bizneset do të përfshihen aktivisht në procesin e edukimit praktik dhe do të krijohen programe që çojnë drejtpërdrejt në punësim. Kjo qasje synon uljen e papunësisë së të rinjve, ngritjen e aftësive profesionale dhe rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike të vendit.

4.3 Arsimi i lartë dhe kërkimi shkencor

Qeveria e PDK-së do të forcojë universitetet publike si institucione me autonomi të plotë, kërkim shkencor aktiv dhe bashkëpunim ndërkombëtar të zgjeruar. Do të rritet cilësia e mësimdhënies universitare dhe do të mbështetet inovacioni si motor i zhvillimit ekonomik. Universitetet kosovare duhet të bëhen institucione konkurruese në hapësirën evropiane të arsimit dhe kërkimit.

4.4 Fondi i Bursave për Studentët

Qeveria e PDK-së do të krijojë **Fondin e Bursave për Studentët**, me vlerë **30 milionë euro në vit**, për mbështetjen e studentëve. Ky fond synon të garantojë qasje të barabartë në arsim të lartë dhe të investojë drejtpërdrejt në kapitalin njerëzor të Kosovës — pavarësisht prejardhjes ekonomike apo sociale të studentit.


4.5 Arsimi joformal dhe kreativiteti rinor

Qeveria e PDK-së do të mbështesë **arsimin joformal**, aktivitetet kulturore, kreative dhe inovative, si pjesë e zhvillimit gjithëpërfshirës të të rinjve. Kjo përfshin programe artistike, kulturore dhe kreative, mbështetje për inovacion dhe ide të reja, si dhe bashkëpunim me sektorin civil dhe privat. Zhvillimi i të riut nuk ndodh vetëm brenda klasës — ndodh edhe në komunitet, në kulturë, në sport dhe në jetën civile.

Arsimi është investim në të ardhmen e Kosovës. Një sistem arsimor i fortë ndërton qytetarë të aftë, ekonomi konkurruese dhe shtet të qëndrueshëm.



***V. Drejtësi e pavarur, e
paanshme dhe efikase***



5. Drejtësi e pavarur, e paanshme dhe efikase

Drejtësia është shtylla e shtetit ligjor. Një sistem drejtësie i pavarur, i fortë dhe efikas është themeli i besimit publik, parakusht për investime dhe kusht i domosdoshëm për integrim evropian. Pa drejtësi të vërtetë, asnjë reformë tjetër nuk mund të konsolidohet dhe asnjë qytetar nuk mund të ndjehet i mbrojtur plotësisht nga shteti i vet.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës angazhohet për ndërtimin e një sistemi gjyqësor që funksionon — që vendos me shpejtësi, me paanësi dhe pa frikë, dhe që zbatohet në praktikë, jo vetëm në letër.

5.1 Pavarësia e gjyqësorit

Pavarësia e plotë e gjyqësorit nga ndikimet politike dhe ekonomike është parakushtit themelor. Qeveria e PDK-së do të forcojë mekanizmat institucionale që garantojnë integritetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve — si në procesin e emërimit, ashtu edhe në atë të llogaridhënies. Asnjë qytetar dhe asnjë institucion nuk duhet të jetë mbi ligjin.

5.2 Lufta kundër korrupsionit dhe krimit

Qeveria e PDK-së do të vazhdojë luftën e vendosur kundër **krimit të organizuar, terrorizmit dhe ekstremizmit** përmes forcimit të kapaciteteve hetimore, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zbatimit rigoroz të ligjit. Korrupsioni është armiku i zhvillimit dhe drejtësisë sociale — dhe PDK e trajton atë si prioritet të qeverisjes, jo si retorikë zgjedhore.

5.3 Digjitalizimi i drejtësisë

Qeveria e PDK-së do të përkrahë **digjitalizimin e plotë të sistemit të drejtësisë** për të rritur transparencën, efikasitetin dhe qasjen e qytetarëve në shërbime gjyqësore. Digjitalizimi do të kontribuojë në përshpejtimin e procedurave, reduktimin e vonesave administrative dhe përmirësimin e

menaxhimit të lëndëve. Qytetarët do të kenë mundësi të ndjekin rrjedhën e çështjeve të tyre, duke rritur besimin e publikut në sistem.

5.4 Zvogëlimi i lëndëve të grumbulluara (backlog) - Drejtësi më e shpejtë për qytetarët

Një nga sfidat më të mëdha të sistemit të drejtësisë është numri i lartë i lëndëve të pazgjidhura. Qeveria e PDK-së do të mbështesë projektet e gjyqësorit për zvogëlimin e backlog-ut, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e drejtësisë. Kjo përkrahje do të përfshijë:

- financim për projekte të posaçme për trajtimin e lëndëve të vjetra;
- rritje të kapaciteteve administrative dhe profesionale;
- digjitalizim të proceseve gjyqësore;
- dhe përmirësim të menaxhimit të lëndëve.



Këto masa do të zbatohen në koordinim të plotë me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, duke respektuar pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit.

Qytetarët kanë të drejtë në drejtësi në kohë të arsyeshme.

5.5 Gjykata e Punës

PDK do të krijojë Gjykatën e Punës si institucion të specializuar për zgjidhjen e shpejtë dhe profesionale të mosmarrëveshjeve të marrëdhënieve të punës. Kjo gjykatë synon trajtim të shpejtë dhe profesional të rasteve të punës, uljen e ngarkesës në gjykatat e rregullta dhe forcimin e sigurisë juridike në marrëdhëniet e punës. Krijimi i kësaj gjykate do të bëhet në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe parimet e pavarësisë së gjyqësorit.

5.6 Ndhimja juridike – Drejtësi e qasshme për të gjithë

Qeveria e PDK-së do të vazhdojë dhe forcojë mbështetjen për ndihmën juridike falas, në mënyrë që drejtësia të jetë e qasshme për të gjithë qytetarët, pavarësisht gjendjes ekonomike. Asnjë qytetar nuk duhet të mbetet pa mbrojtje juridike për shkak të pamundësisë financiare. Drejtësia e arritshme është drejtësia e vërtetë.

5.7 Zbatimi i vendimeve gjyqësore

Një vendim gjyqësor që nuk zbatohet nuk është drejtësi — është dëshpërim. Qeveria e PDK-së do të forcojë mekanizmat institucionalë që sigurojnë zbatim të plotë dhe në kohë të vendimeve gjyqësore, duke e kthyer drejtësinë nga premtim abstrakt në realitet konkret të jetës së qytetarëve.

5.8 Drejtësia si themel i shtetit

Një sistem drejtësie i pavarur, i fortë dhe efikas nuk është vetëm çështje ligjore — është çështje e besimit, zhvillimit dhe dinjitetit kombëtar. Drejtësia e vërtetë mbron të dobëtin, shpërblen punën e ndershme dhe garanton siguri për çdo qytetar. Ky është themeli mbi të cilin PDK synon të ndërtojë Kosovën e së ardhmes.





VI. Kultura, rinia dhe sporti

6. Kultura, rinia dhe sporti

6.1 Identitet kombëtar, energji rinore dhe investim në shoqëri të shëndetshme

Kultura, rinia dhe sporti janë shtylla të rëndësishme të zhvillimit shoqëror, identitetit kombëtar dhe kohezionit social. Një shtet që investon në këto fusha ndërton qytetarë aktivë, krijues dhe të lidhur me vendin e tyre. Këto politika nuk janë luks i një shoqërie të pasur, por **kusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe stabilitet afatgjatë.**

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do t'i trajtojë kulturën, rininë dhe sportin si **politika publike me ndikim të drejtpërdrejtë ekonomik, social dhe diplomatik**, duke krijuar kushte për shprehje krijuese, përfshirje rinore dhe jetë aktive.

6.2 Kultura si vlerë dhe identitet kombëtar - Mbështetje për krijimtarinë dhe trashëgiminë kulturore

Qeveria e PDK-së do të forcojë politikat për mbështetjen e kulturës dhe artit, duke e trajtuar kulturën si pjesë të identitetit kombëtar dhe prezantimit ndërkombëtar të Kosovës.

Kjo përfshin:

- mbështetje për artistët dhe institucionet kulturore;
- financim transparent dhe konkurrues për projekte kulturore;
- ruajtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore;
- zhvillim të diplomacisë kulturore si mjet afirmimi ndërkombëtar.

Kultura do të mbështetet si sektor krijues dhe si pjesë e ekonomisë kulturore.

6.3 Rinia si prioritet kombëtar - Mundësi, pjesëmarrje dhe perspektivë

Rinia është potenciali më i madh i Kosovës. Politikat rinore të Qeverisë së PDK-së do të fokusohen në krijimin e mundësive reale për zhvillim personal, profesional dhe shoqëror.

Masat do të përfshijnë:

- programe për fuqizimin e të rinjve;
- mbështetje për iniciativa rinore dhe organizata të të rinjve;
- hapësira publike për aktivitete rinore;
- përfshirje të të rinjve në vendimmarrje.

Qëllimi është që të rinjtë të shohin të ardhmen e tyre në Kosovë, jo jashtë saj.

6.4 Arsimi joformal dhe kreativiteti - Zhvillim përtej klasës

Qeveria e PDK-së do të mbështesë arsimin joformal, aktivitetet kulturore, kreative dhe inovative, si pjesë e zhvillimit gjithëpërfshirës të të rinjve. Kjo përfshin:

- programe artistike, kulturore dhe kreative;
- mbështetje për inovacion dhe ide të reja;
- bashkëpunim me sektorin civil dhe privat.



6.5 Sporti si investim në shëndet dhe përfaqësim shtetëror - Mbështetje për sportistët dhe federatat sportive

Sporti është faktor i rëndësishëm për shëndetin publik, disiplinën shoqërore dhe përfaqësimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Qeveria e PDK-së do të:

- rrisë mbështetjen për federatat sportive;
- mbështesë sportistët profesionistë dhe amatorë;
- investojë në programe sportive për fëmijë dhe të rinj.

Sporti do të trajtohet si politikë publike dhe jo si aktivitet marginal.

6.6 Infrastruktura sportive - Kushte dinjitoze për sport dhe aktivitete rinore

Qeveria e PDK-së do të investojë në ndërtimin dhe modernizimin e infrastrukturës sportive në të gjithë vendin.

Kjo përfshin:

- palestra sportive;
- fusha sportive lokale;
- qendra multifunkionale për të rinjtë;
- projekte të mëdha kombëtare.

6.7 Ndërtimi i Stadiumit Olimpik Kombëtar


Qeveria e PDK-së do të realizojë ndërtimin e Stadiumit Olimpik Kombëtar, si projekt strategjik për zhvillimin e sportit, organizimin e garave ndërkombëtare dhe promovimin e Kosovës.

Ky projekt do të:

- krijojë kushte për ngjarje sportive ndërkombëtare;
- rrisë turizmin sportiv;
- kontribuojë në zhvillimin ekonomik;
- forcojë identitetin shtetëror.

6.8 Kultura, rinia dhe sporti si faktor zhvillimi shoqëror

Investimi në kulturë, rini dhe sport është investim në shoqëri të shëndetshme, aktive dhe të bashkuara. Qeveria e PDK-së synon të krijojë politika që fuqizojnë qytetarët, nxisin krijimtarinë dhe forcojnë lidhjen e shoqërisë me shtetin.



VII. Siguria



7. SIGURIA

Siguria është një nga funksionet themelore të shtetit dhe kusht i domosdoshëm për stabilitet politik, zhvillim ekonomik dhe jetë të qetë për qytetarët. Një shtet i sigurt garanton rend publik, mbron jetën dhe pronën e qytetarëve dhe është i përgatitur për të përballuar krizat, emergjencat dhe kërcënimet e ndryshme.

Kosova përballlet me sfida të shumta në fushën e sigurisë: nevojë për forcim të kapaciteteve të Policisë, reagim më të shpejtë ndaj emergjencave, mbrojtje më të mirë dhe koordinim më efikas ndërinstitucional.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do të ndërtojë një sistem sigurie modern, profesional dhe gjithëpërfshirës, që garanton rend, mbrojtje dhe reagim të shpejtë në çdo situatë.

7.1 Forcimi i Policisë së Kosovës - Siguri publike dhe rend ligjor

Policia e Kosovës është shtylla kryesore e rendit publik dhe sigurisë së përditshme të qytetarëve. Qeveria e PDK-së do të investojë në forcimin e kapaciteteve të Policisë përmes:

- përmirësimin të kushteve të punës dhe pajisjeve;
- trajnimeve profesionale të vazhdueshme;
- modernizimit të mjeteve operative.

Qëllimi është një polici profesionale, e pranishme dhe e besueshme për qytetarët.

7.2 Reagimi ndaj emergjencave - Gatishmëri dhe koordinim institucional

Reagimi i shpejtë dhe i koordinuar ndaj emergjencave është jetik për mbrojtjen e jetës dhe pronës. Qeveria e PDK-së do të:

forcojë kapacitetet e emergjencave civile;

- përmirësojë koordinimin ndërmjet Policisë, zjarrfikësve, shërbimeve shëndetësore dhe institucioneve të tjera;
- modernizojë sistemet e komunikimit emergjent.

7.3 Krijimi i Njesisë së Helikopterëve - Reagim i shpejtë dhe mbulim kombëtar

Qeveria e PDK-së do të krijojë Njesisë të Helikopterëve, si kapacitet strategjik për sigurinë kombëtare dhe reagimin ndaj emergjencave.

Kjo njësi do të përdoret për:

- operacione kërkim-shpëtimi;
- reagim në fatkeqësi natyrore;
- transport emergjent mjekësor;
- mbështetje për Policinë dhe institucionet e sigurisë;
- operacione në terrene të vështira.



Krijimi i kësaj njësie rrit ndjeshëm kapacitetin e shtetit për reagim të shpejtë dhe efikas.

7.4 Themelimi i Gardës Kombëtare të Kosovës - Kapacitet shtesë për siguri, mbrojtje civile dhe reagim në kriza

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për **themelimin e Gardës Kombëtare të Kosovës**, si strukturë shtesë dhe mbështetëse e sistemit të sigurisë kombëtare, në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standartet euroatlantike.

Garda Kombëtare do të ketë rol mbrojtës, **civil e reagues** dhe **nuk do të zëvendësojë** as Policinë e Kosovës dhe as Forcën e Sigurisë së Kosovës, por do të funksionojë si **kapacitet plotësues**, veçanërisht në situata emergjente dhe kriza të jashtëzakonshme.

Roli i Gardës Kombëtare do të përfshijë:

- reagimin në raste të fatkeqësive natyrore, si përmytje, tërmete dhe zjarre;
- mbështetjen e mbrojtjes civile dhe shërbimeve emergjente;
- asistimin e institucioneve të sigurisë në raste krizash të mëdha;
- kontributin në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, kur kjo kërkohet nga autoritetet kompetente.

Themelimi i Gardës Kombëtare do të:

- rrisë kapacitetin shtetëror për reagim të shpejtë dhe të koordinuar;
- përmirësojë gatishmërinë kombëtare ndaj krizave;
- forcojë ndjenjën e sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarëve.

Kjo strukturë do të ndërtohet mbi këto parime:

- profesionalizëm,
- trajnim të specializuar,
- koordinim të plotë ndërinstytucional,

- respektim të plotë të rendit kushtetues dhe sundimit të ligjit.

Garda Kombëtare do të zhvillohet gradualisht, me planifikim të kujdesshëm dhe në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, duke u integruar në arkitekturën e përgjithshme të sigurisë së Republikës së Kosovës.

7.5 Mbrojtja civile dhe menaxhimi i krizave - Shtet i përgatitur për situata të jashtëzakonshme

Qeveria e PDK-së do të forcojë sistemin e mbrojtjes civile përmes:

- planeve të qarta për menaxhimin e krizave;
 - trajnimeve për institucionet dhe komunitetet lokale;
 - investimeve në pajisje dhe infrastrukturë emergjente.
- Qëllimi është minimizimi i dëmeve dhe mbrojtja e jetës në raste të fatkeqësive natyrore apo krizave të tjera.

7.6 Siguria kufitare - Mbrojtje e territorit dhe rend ligjor

Siguria kufitare është komponent kyç i sigurisë kombëtare. PDK angazhohet për:



- modernizimin e pajisjeve dhe teknologjisë kufitare;
- trajnime të avancuara për stafin;
- bashkëpunim të ngushtë ndërkombëtar për luftimin e krimit ndërkufitar.

7.7 Lufta kundër krimit të organizuar dhe ekstremizmit - Siguri për shoqërinë dhe sundim i ligjit

Qeveria e PDK-së do të vazhdojë luftën e vendosur kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe ekstremizmit përmes:

- forcimit të kapaciteteve hetimore;
- bashkëpunimit ndërkombëtar;
- zbatimit rigoroz të ligjit.

7.8 Siguria në komunitet - Parandalim dhe bashkëpunim me qytetarët

Siguria fillon në komunitet. PDK do të forcojë modelet e policimit në komunitet për të:

- rritur besimin ndërmjet Policisë dhe qytetarëve;
- parandaluar kriminalitetin;
- përmirësuar sigurinë lokale.

7.9 Forcimi i sigurisë kibernetike kombëtare

Qeveria e PDK-së do të zhvillojë kapacitete shtetërore për sigurinë kibernetike, për mbrojtjen e institucioneve publike, infrastrukturës kritike dhe të dhënave të qytetarëve nga kërcënimet digjitale dhe hibride.

7.10 Siguria si parakusht për zhvillim dhe stabilitet

Siguria është bazë për zhvillim ekonomik, investime dhe jetë të qetë. Politikat e Qeverisë së PDK-së synojnë ndërtimin e një ambienti të sigurt ku qytetarët ndihen të mbrojtur dhe të lirë.



VIII. Politika e jashtme



8. POLITIKA E JASHTME

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës duhet të jetë instrument i stabilitetit, zhvillimit dhe sigurisë kombëtare. Një shtet i vogël, por me ambicie të qarta euroatlantike, ka nevojë për një politikë të jashtme të matur, të parashikueshme dhe të koordinuar ngushtë me aleatët strategjikë.

Në vitet e fundit, Kosova ka humbur besueshmëri ndërkombëtare për shkak të qasjeve të paqëndrueshme, mungesës së koordinimit me partnerët dhe improvizimeve në politikën e jashtme. Kjo ka rezultuar në izolim relativ, tensione të panevojshme dhe dobësim të pozitës ndërkombëtare të vendit.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do ta rikthejë **politikën e jashtme** si politikë shtetërore, jo partiake, duke ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme, besim të ndërsjellë dhe partneritet afatgjatë me aleatët tanë kryesorë.

8.1 Integrimi evropian – Proces reformues dhe angazhim serioz shtetëror

Integrimi në Bashkimin Evropian mbetet objektiv strategjik dhe shumë i qartë i Republikës së Kosovës. Qeveria e PDK-së do ta trajtojë procesin e integritit evropian si projekt gjithëpërfshirës shtetëror, duke e lidhur drejtpërdrejt me reformat e brendshme dhe sundimin e ligjit.

Angazhimi për integrim evropian do të përfshijë:

- zbatim të plotë dhe të qëndrueshëm të reformave në drejtësi, administratë dhe ekonomi;
- përmbushje të obligimeve që dalin nga proceset integruese;
- dialog të vazhdueshëm politik me institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare.

Kosova do të pozicionohet si partner serioz dhe konstruktiv në procesin evropian.

8.2 Partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Partneriteti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është themeli i shtetësisë, sigurisë dhe zhvillimit demokratik të Kosovës. Ky partneritet nuk është vetëm historik, por edhe strategjik për të ardhmen.

Qeveria e PDK-së do të punojë për:

- rikthimin e koordinimit të plotë politik dhe diplomatik me SHBA-në;
- forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes;
- zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe institucional.

Qeveria e PDK-së do të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të rinisur

si platformë e rregullt për bashkëpunim në siguri, ekonomi, energji dhe demokraci, duke e forcuar partneritetin strategjik afatgjatë.

Kosova do të veprojë gjithmonë në harmoni me interesat strategjike të SHBA-së dhe vlerat euroatlantike.

8.3 Integrimi në NATO - Siguri afatgjatë dhe stabilitet rajonal

Anëtarësimi në NATO është objektiv strategjik për sigurinë kombëtare të Kosovës. Qeveria e PDK-së do të intensifikojë përpjekjet për avancimin e Kosovës drejt strukturave euroatlantike të sigurisë.



- forcimin e kapaciteteve të sigurisë dhe mbrojtjes;
- rritjen e interoperabilitetit me vendet anëtare të NATO-s;
- përmbushjen e standardeve politike dhe ushtarake të Aleancës.

Kosova do të vazhdojë të kontribuojë në stabilitetin rajonal si faktor i paqes.

Qeveria e PDK-së do të punojë për anëtarësimin e Kosovës në Partneritetin për Paqe, si hap i rëndësishëm drejt integritit të plotë në NATO dhe forcimit të sigurisë kombëtare.

8.4 Marrëdhëniet rajonale - Stabilitet, bashkëpunim dhe fqinjësi e mirë

Qeveria e PDK-së do të zhvillojë marrëdhënie të mira fqinjësore, të bazuara në respekt të ndërsjellë, sovranitet dhe integritet territorial.

Bashkëpunimi rajonal do të shërbejë për:

- ndërtimin e stabilitetit afatgjatë;
- zhvillimin ekonomik dhe ndërlidhjen infrastrukturore;
- avancimin e proceseve integruese evropiane.

Kosova do të jetë aktor konstruktiv në rajon.

8.5 Dialogu Kosovë-Serbi - Proces i koordinuar, i drejtë dhe i qëndrueshëm

Dialogu me Serbinë është proces kompleks që kërkon maturi, unitet të brendshëm dhe koordinim të plotë me aleatët strategjikë.

Qeveria e PDK-së do të:

- zhvillojë dialogun në koordinim të ngushtë me SHBA-në dhe BE-në;
- mbrojë sovranitetin dhe rendin kushtetues të Kosovës;
- synojë marrëveshje të qëndrueshme dhe të zbatueshme ndërkombëtarisht.

Asnjë proces dialogu nuk do të zhvillohet në dëm të interesit shtetëror.

8.6 Diplomacia ekonomike - Politika e jashtme në shërbim të zhvillimit


Politika e jashtme do të vihet drejtpërdrejt në shërbim të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Qeveria e PDK-së do të forcojë diplomacinë ekonomike për të tërhequr investime dhe për të mbështetur eksportet.

Kjo përfshin:

- promovimin aktiv të Kosovës si destinacion investimesh;
- përdorimin e rrjetit diplomatik për hapjen e tregjeve të reja;
- përkrahjen e bizneseve kosovare jashtë vendit.

8.7 Njohjet bilaterale dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare - Konsolidim i subjektivitetit shtetëror

Qeveria e PDK-së do të intensifikojë përpjekjet për sigurimin e njohjeve bilaterale dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, si pjesë e konsolidimit të plotë të subjektivitetit ndërkombëtar.



Kjo do të realizohet përmes diplomacisë aktive, ndërtimit të aleancave dhe angazhimit të vazhdueshëm bilateral dhe multilateral.

Qeveria e PDK-së do të intensifikojë përpjekjet për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, duke forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe integrimin institucional evropian, si dhe do të punojë për fitimin e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përmes reformave të thella, stabilitetit institucional dhe rikthimit të besueshmërisë së Kosovës në raport me Bashkimin Evropian.

8.8 Roli i diasporës - Fuqi diplomatike dhe ekonomike e Kosovës

Diaspora shqiptare është aset strategjik i Kosovës. Qeveria e PDK-së do të ndërtojë mekanizma institucionale për përfshirjen aktive të diasporës në diplomaci, ekonomi dhe zhvillim.

Diaspora do të trajtohet si partner strategjik i shtetit.

8.9 Profesionalizimi i shërbimit diplomatik


Politika e jashtme do të udhëhiqet nga profesionalizmi, meritokracia dhe koordinimi institucional. Qeveria e PDK-së do të forcojë shërbimin diplomatik përmes trajnimeve, përzgjedhjes meritore dhe qartësisë strategjike.

8.10 Politika e jashtme si garanci e stabilitetit dhe zhvillimit

Një politikë e jashtme e qëndrueshme garanton siguri, zhvillim dhe dinjitet shtetëror. Kosova do të rikthehet si partner i besueshëm, serioz dhe i respektuar në arenën ndërkombëtare.



IX. Sovraniteti Digjital dhe Inteligjenca Artificiale



9. Sovraniteti Digjital dhe Inteligjenca Artificiale — Burimi ynë më i madh nuk është nën tokë

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë. Çdo ditë, mijëra të rinj kosovarë shkruajnë kod, ndërtojnë produkte digjitale dhe ofrojnë shërbime teknologjike për kompanitë më të mëdha në botë — por profitet, pronësia intelektuale dhe vlera e shtuar mbeten jashtë. Ky model — shitja e orëve të punës pa zotëruar asgjë — është kurth ekonomik afatgjatë. Kosova meriton më shumë. Kosova mund të bëjë më shumë.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do të ndërtojë sovranitetin digjital të Kosovës — një vizion ku vendi ynë nuk është thjesht ofrues i shërbimeve të lira për botën, por pronar i teknologjisë dhe algoritmeve që bota i blen. Burimi ynë më i madh natyror nuk gjendet nën tokë — ai gjendet prapa ekranit të laptopëve të rinisë sonë.

9.1 Fondi Kombëtar i Bashkë-Investimit — Tregu zgjedh fituesit, jo politika

Qeveria e PDK-së do të themelojë Fondin Kombëtar të Bashkë-Investimit për Inteligjencë Artificiale dhe Teknologji, bazuar në një model të pastër tregu që eliminon nepotizmin dhe korrupsionin nga rrënja.

Parimi është i thjeshtë dhe revolucionar: shteti nuk investon direkt dhe nuk zgjedh fituesit. Nëse një startup vendor i Inteligjencës Artificiale ose Automatizimit arrin të sigurojë investim privat nga investitorë profesionistë — qoftë nga rrjetet vendore si KOSBAN, qoftë nga akseleratorë ndërkombëtarë — shteti automatikisht bën matching 1:1, duke injektuar kapital shtesë si grant pa marrë aksione, ose përmes instrumenteve standarde financiare.

Pse ky model është superior ndaj granteve tradicionale? Sepse vlerësimin e rrezikut dhe cilësisë së

startup-it e bëjnë investitorët privatë profesionistë — jo komisionet publike shtetërore që shpesh u mungon kompetenca për të gjykuar kompanitë e teknologjisë. Shteti vetëm shton karburant tek ata që tregu ka tashmë vërtetuar. Kjo kursen paranë e taksapaguesve, mbron interesin publik dhe i jap procesit integritet të plotë.

Ky model gjithashtu dyfishon fuqinë e kapitalit të diasporës. Çdo euro që një inxhinier i diasporës investon në një startup kosovar bëhet dy euro — duke krijuar një efekt zinxhir që tërheq kapital, ekspertizë dhe rrjete ndërkombëtare drejtpërdrejt në ekonominë vendore.

Sandbox Rregullator B2G — Kosova si laborator i inovacionit

Sfida më e madhe për startup-et kosovare nuk është vetëm zhvillimi i produktit — është gjetja e klientit të parë institucional që u jep legjitimitet global. Qeveria e PDK-së do të adresojë këtë pengesë strukturore përmes krijimit të Sandbox-it Rregullator të AI-së — një zone të sigurt ligjore ku startup-et e certifikuar të Inteligjencës Artificiale mund të integrojnë dhe testojnë zgjidhjet e tyre në të dhëna publike të anonimizuar dhe në procese reale qeveritare.



Fushat e aplikimit do të përfshijnë menaxhimin e infrastrukturës, prokurimin publik, digjitalizimin e shërbimeve dhe platformat e e-Qeverisjes. Nëse një startup vërteton se zgjidhja e tij me AI rrit efikasitetin e një shërbimi publik — për shembull, duke ulur koston e mirëmbajtjes komunale ose duke përshpejtuar ndjeshëm procesin e prokurimit — shteti i garanton një kontratë të parë të shpejtë dhe të rregullt me institucionet publike.

Efekti i kësaj qasje shkon shumë përtej kufijve të Kosovës. Një rast studimi i suksesshëm me një qeveri sovranë i jep startup-it kosovar legjitimitet institucional të jashtëzakonshëm — dhe e hap derën për të shitur të njëjtin produkt në Gjermani, Britani të Madhe, Shtetet e Bashkuara apo kudo tjetër në botë. Kosova bëhet trampolina, jo destinacioni final.

9.2 Pronësia Intelektuale mbetet në Kosovë

Modeli aktual i outsourcing-ut është kurth i llojit të vet: profitet kryesore dhe vlera e shtuar shkojnë te kompanitë e huaja, ndërsa Kosova mban vetëm pagën orare. Qeveria e PDK-së do të ndryshojë këtë ekuacion duke financuar dhe mbështetur zhvillimin e Pronësisë Intelektuale (IP) direkt brenda vendit. Kur margjinat e larta të fitimit dhe taksat korporative mbeten në Kosovë, ato financojnë shkollat, spitalet dhe infrastrukturën e gjeneratave të ardhshme.

9.3 Ndalja e ikjes së trurit — Të rinjtë qëndrojnë kur mundësia është këtu

Ikja e trurit është një nga problemet strukturore më të rënda të Kosovës. Të rinjtë largohen jo sepse nuk duan të qëndrojnë — por sepse mundësitë ekonomike nuk janë këtu. Qeveria e PDK-së do ta kthejë këtë dinamikë duke ndërtuar një ekosistem të inovacionit që ofron karriera ambicioze, kompensim konkurrues dhe mundësi pronësie — këtu, në Kosovë. Kur një i ri mund të ndërtojë dhe zotërojë kompaninë e tij teknologjike në Prishtinë me mbështetjen e shtetit dhe

kapitalit ndërkombëtar, arsyeja për t'u larguar zvogëlohet ndjeshëm.

9.4 Digjitalizimi i shërbimeve publike

Paralelisht me mbështetjen e sektorit privat, Qeveria e PDK-së do të transformojë administratën shtetërore përmes **digjitalizimit të plotë të shërbimeve publike**. Qytetarët nuk duhet të humbasin kohë dhe energji duke naviguar burokraci të panevojshme — çdo shërbim që mund të ofrohet online, do të ofrohet online, me shpejtësi, transparencë dhe siguri. E-qeverisja nuk është luks i vendeve të pasura — është standardi minimal që çdo qytetar kosovar e meriton sot.

9.5 Infrastruktura digjitale kombëtare

Interneti i shpejtë dhe i besueshëm është infrastruktura e shekullit të 21-të — po aq thelbësore sa rrugët dhe energjia. Qeveria e PDK-së do të investojë në **zgjerimin e rrjetit kombëtar të brezit të gjerë**, duke mbuluar edhe zonat rurale dhe periferike. Asnjë shkollë, asnjë biznes dhe asnjë familje kosovare nuk duhet të mbetet jashtë ekonomisë digjitale për shkak të mungesës së infrastrukturës.



9.6 Qendrat e të Dhënave — Infrastruktura e Sovranitetit Digjital

Çdo ekonomi digjitale moderne ka nevojë për një shtyllë fizike mbi të cilën ndërtohet: **qendrat e të dhënave**. Këto janë objektet që ruajnë, përpunojnë dhe transmetojnë informacionin mbi të cilin funksionojnë qeveritë, bizneset dhe qytetarët. Sot, shumica e të dhënave të institucioneve dhe bizneseve kosovare ruhen në serverë jashtë vendit — në Gjermani, Holandë apo gjetkë — duke krijuar varësi strukturore, kosto të larta dhe rreziqe reale për sovranitetin e informacionit kombëtar.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do të ndryshojë këtë situatë rrënjësisht.

9.7 Qendra Kombëtare e të Dhënave

Qeveria e PDK-së do të investojë në ndërtimin e **Qendrës Kombëtare të të Dhënave**, si infrastrukturë strategjike shtetërore. Kjo qendër do të sigurojë ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të institucioneve publike brenda kufijve të Kosovës — duke garantuar sovranitetin e informacionit, sigurinë kibernetike dhe pavarësinë nga operatorët e huaj. Të dhënat e shtetit kosovar duhet të mbrohen nga shteti kosovar.

9.8 Tërheqja e Investimeve Private në Qendra të të Dhënave

Përtej qendrës shtetërore, Qeveria e PDK-së do të krijojë **kushte aktive për tërheqjen e investimeve private ndërkombëtare** në ndërtimin e qendrave komerciale të të dhënave në Kosovë. Kosova ka avantazhe konkrete dhe të paçmueshme për këtë industri: kosto të energjisë konkurruese, klimë të favorshme për ftohje, pozitë gjeografike qendrore në Ballkanin Perëndimor dhe një kornizë ligjore në harmonizim me standardet evropiane. Me politikën e duhur — lehtësi tatimore, procedura të shpejta licencimi dhe garanci investimi — Kosova mund të bëhet destinacioni kryesor rajonal për infrastrukturën e të dhënave.

9.9 Qendrat e të Dhënave si Motor Ekonomik

Investimet në qendrat e të dhënave nuk janë thjesht investime teknike — janë investime ekonomike me impakt të gjerë. Çdo qendër e të dhënave krijon vende pune të kualifikuara dhe të paguar mirë, gjeneron të ardhura tatimore të qëndrueshme, stimulon zhvillimin e ekosistemit lokal të teknologjisë dhe tërheq startup-e e kompani ndërkombëtare që kanë nevojë për infrastrukturë afër vendeve të tyre të operimit. Ky zinxhir efektesh e bën sektorin e qendrave të të dhënave një nga investimet me kthimin më të lartë afatgjatë që Kosova mund të bëjë.

9.10 Siguria Kibernetike dhe Mbrojtja e të Dhënave

Ndërtimi i qendrave të të dhënave do të shoqërohet me **forcimin e kornizës kombëtare të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave**, në përputhje me standardet e BE-së. Qytetarët dhe bizneset kosovare kanë të drejtë të dinë që të dhënat e tyre janë të mbrojtura — juridikisht, teknikisht dhe institucionally. Kosova do të ndërtojë reputacionin e një vendi ku të dhënat trajtohen me përgjegjësi dhe profesionalizëm të lartë — dhe ky reputacion do të jetë në vetvete avantazh konkurrues ndërkombëtar.



PËRMBYLLJE

Kosova ka kaluar shumë. Ka kaluar periudha sfide, sakrifica të mëdha dhe momente vendimtare që e kanë formësuar si shtet dhe si shoqëri. Çdo gjeneratë e këtij vendi ka paguar çmimin e vet për lirinë, për dinjitetin dhe për të drejtën për të vendosur vetë për të ardhmen e vet. Ne e nderojmë atë sakrificë çdo ditë dhe e ndiejmë çdo ditë peshën e përgjegjësisë që vjen me të.

Sot, Kosova qëndron përpara një zgjedhjeje të rëndësishme. Jo thjesht zgjedhje mes partive apo kandidatëve, por zgjedhje mes dy rrugëve të ndryshme për të ardhmen. Njëra rrugë është e njohur: premtime të mëdha, rezultate të vogla, institucione të dobëta dhe qytetarë të zhgënjyer.

Rruga tjetër, rruga që PDK-ja propozon, është rruga e punës së ndershme, e vendimeve të vështira, e reformave të vërteta dhe e një vizion të qartë për vendin që duam të jemi.

Ky program nuk është listë dëshirash. Është plan qeverisjeje, i ndërtuar mbi realitetin e Kosovës, mbi nevojat e qytetarëve të saj dhe mbi bindjen se ky vend mund dhe duhet të jetë më i mirë.

Më i drejtë. Më i sigurt. Më i zhvilluar. Më i respektuar në botë. Ne nuk premtojmë mrekulli, por premtojmë punë të ndershme, vendime të përgjegjshme dhe një qeveri që qëndron pranë çdo qytetari, jo vetëm pranë atyre me zë të lartë e lidhje të forta.

Besojmë në Kosovën që mbron qytetarët e saj, që investon në fëmijët e saj, që respekton punëtorët, pensionistët dhe familjet, që ndërton partneritete të forta dhe nuk izolohet. Besojmë në Kosovën digjitale, të gjelbër, të arsimuar dhe të integruar në familjen evropiane. Besojmë në Kosovën që bashkon dhe nuk përçan, që i sheh ndryshimet si forcë, jo si kërcënim.

Ky program është ftesë, për çdo qytetar, për çdo familje, për çdo të ri që ende beson se Kosova ia vlen. Le t'i lëmë pas ndasitë dhe ta ndërtojmë së bashku Kosovën që e meritojmë. Sepse vetëm bashkë, mund të ecim përpara.



STOP KRIZĚS

NDRYSHO KOSOVĚN

PDK 125

Bedri Hamza 1



ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2026 PREVREMENI IZBORI ZA SKUPŠTINU REPUBLIKE KOSOVA 2026



Shënjoni **VETËM NJË** subjekt politik
Oznaçite **SAMO JEDAN** politički subjekat



Shënjoni **DERI NË DHJETË** kandidatë
Oznaçite **DO DESET** kandidata

<input checked="" type="checkbox"/>	2	3	4	5
6	7	8	9	10
11	12	13	14	15
16	17	18	19	20
21	22	23	24	25
26	27	28	29	30
31	32	33	34	35
36	37	38	39	40
41	42	43	44	45
46	47	48	49	50
51	52	53	54	55
56	57	58	59	60
61	62	63	64	65
66	67	68	69	70
71	72	73	74	75
76	77	78	79	80
81	82	83	84	85
86	87	88	89	90
91	92	93	94	95
96	97	98	99	100
101	102	103	104	105
106	107	108	109	110



125 **PDK** PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK

STOP KRIZËS

NDRYSHO KOSOVËN

PDK 125